



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

**VENDIM**

Nr. 14, dt. 18.12.2017

***MBI MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
2018-2020 PËR KËSHILLIN E QARKUT***

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, te Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimit Plotësues nr. 10/1 dt. 28.02.2017 dhe nr. 10/2 datë 13.07.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, si dhe të Vendimit të Keshillit të Qarkut nr. 10 date 26.07.2017 “Mbi miratimin paraprak të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 për Këshillin e Qarkut”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

**V E N D O S I**

1. Të miratoje Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 për Këshillin e Qarkut Korçë.
2. Të miratojë Tabelen 1 “Parashikimi i të ardhurave afatmesme të Njesise të Veteqeverisjes Vendore”, Tabelen 2 “Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2018-2020”, Tabelen 3 “Format per planifikimin e tavaneve afatmesme të shpenzimeve për njesinë e vetëqeverisjes vendore” bashkangjitur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve, të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomise materialin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

